




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 474/ 19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Goran Milenkovic -Kryetar, z. Nuhi Paçarizi Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “ N.T Rimida ”- Graqanic, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: “ AGRI BAU ” SH.P.K- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “ Furnizim me motokultivator dhe pajisje përcjellëse ” me nr.prok : 615-19-2206-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues /AK/ – Komuna e Podujevës, më datën 29.08.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “N.T Rimida ”- Graqanic, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Furnizim me motokultivator dhe pajisje përcjellëse ” me nr.prok: 615-19-2206-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues /AK/ - Komuna e Podujevës .

II. VERTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “ Furnizim me motokultivator dhe pajisje përcjellëse ” me nr.prok : 615-19-2206-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues /AK/ – Komuna e Podujevës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “ N.T Rimida ” - Graqanic, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 16.04.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 27.05.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar është bërë me dt: 19.07.2019.

Kërkesa për rishqyrtim është bërë dt: 23.07.2019.

Operatori ekonomik ankues “ N.T Rimida ” - Graqanic, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 01.08.2019, me nr. 474 / 19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Furnizim me motokultivator dhe pajisje përejellëse” me nr.prok : 615-19-2206-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues /AK/ – Komuna e Podujevës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 3, 6, 7, 28, 59.4 ,60 dhe 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 06.08.2019, ka autorizuar ekspertin profesionale të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt: 15.08.2019, sqaron lidhur me pretendimin e OE ankues, se jemi eliminuar nga ana e AK pasi që jemi shpërblyer me kontratë dhe pas kërkesës për rishqyrtim nga ana e OE “ AGRI BAU ” Sh.p.k AK -KK Podujeve, shpërblen me kontrate OE “ AGRI BAU ” Sh.p.k duke na eliminuar neve për shkak se iu mungojnë referencat edhe pse jemi me çmim me te

ulet, eksperti shqyrtues pas shqyrtimit te lendes ne lidhje me referencat e OE ankues N.T "Rimida" konstaton se AK ka kërkuar sqarim ne lidhje me referencat dhe fillimisht i ka pranuar si te vlefshme por pas kërkesës për rishqyrtim ka vërejtur ese OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar referenca ashtu siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate, pas analizimit te referencave eksperti shqyrtues vëren se OE N.T "Rimida" ka ngarkuar ne sistem referenca e datës 20/02/2018 me titull "Furnizim me pajisje bujqësore për vitin 2017, me nr te kontratës 01012017 te cilën OE "Rimida" e ka vulosur Referencën me vulën e vet. Po ashtu edhe tek Referenca me nr. te kontratës 010112018 me titull "Furnizimi me pajisje bujqësore për vitin 2018" date 15.01.2019, OE N.T " Rimida " ka vepruar njëjtë duke vulosur me vulën e vet referencën te cilën e lëshon një Kompani tjetër. Duke u bazuar ne këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE është pjesërisht i bazuar .

Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankues, se OE i rekomanduar për kontrate " AGRI BAU" SH.p.K ka ofruar dëshmi katalogun i cili është pa përshkrim dhe specifikime teknike te detajuar (nuk është siç është kërkuar nga ana e AK) ,KK Podujeve tek pikat 1.1,1.2,1.3,1.4,1.5,1.6,1, eksperti shqyrtues bazuar ne dëshminë ne dispozicion konstaton se OE " AGRI BAU" Sh.p.K ka ngarkuar katalogun ashtu siç e ka cekur OE ankues vlen te përmendet se OE i rekomanduar për kontrate e ka nënshkruar një deklarate se përmbush specifikat teknike edhe pse nuk ka qene kriter nga ana e AK, bazuar ne dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i qëndrueshëm nga ana e ekspertese shqyrtuese.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Duke u bazuar ne sqarimet e lartpërmendura ,eksperti shqyrtues i propozon Panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues N.T "Rimida" , të aprovohet si pjesërisht e bazuar (për arsye qe u cek te përgjigjja ne pretendimin nr. 1 dhe 2,propozon Panelit shqyrtues qe te anulohet Vendimi i AK për dhënie te kontratës dhe rekomandon qe lënda të kthehet ne Rivlerësim.

Operatori ekonomik përmes parashtrësës me shkrim të datës: 16.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtrësës me shkrim të datës: 19.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 29.08.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, ndërsa ekspertja profesionale e prokurimit nuk mori pjesë ne seance, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjate prezantimit ne seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Fetoshi deklaroj: Ne konsiderojmë qe ne ketë aktivitet të prokurimit jemi eliminuar pa bazë ligjore , faktikisht ju informojmë se gjatë vlerësimit te pare Autoriteti Kontraktues na ka rekomanduar për kontrate neve mirëpo pas kërkesës për rishqyrtim qe ka bre OE qe tani është i rekomanduar për kontrate Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar se na mungojnë referencat e mjaftueshme për 3 vitet e fundit. Kjo arsyeje është e paqëndrueshme për faktin se ne i kemi te gjitha referencat për kontrata te cilat janë te listuara ne liste mirëpo Autoriteti Kontraktues i është referuar 2 referencave te cilat janë lëshuar nga një kompani private e te cilat fillimisht kanë pasur lëshime teknike por qe me sqarime shtese ne i kemi ofruar këto 2 referenca te cilat janë ne përputhje me kërkesën Autoritetit Kontraktues se bashku me këto referenca i kemi bashkangjitur edhe kontratat edhe qarkullimin bankar për këto kontrata por qe për Autoriteti Kontraktues nuk kanë mjaftuar këto dëshmi ne mund ti dëshmoj panelit këto dëshmi te cilat i kemi këtu prezent mirëpo e inkurajojmë edhe panelin po ashtu edhe Autoriteti Kontraktues qe lirisht te bëjë verifikim te kontratave dhe referencave madje edhe transaksioneve bankare ne lidhje me këto kontrata dhe referenca. Pra nenin 59.2 dhe 72 i LPP-së dhe neni 39 i RrUOPP-së nuk është përdorur ne mënyrë te drejt nga Autoriteti Kontraktues dhe njëkohësisht ka vepruar ne mënyre diskriminuese me neve si OE ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-së. Sa i përket OE te rekomanduar për kontrate konsiderojmë qe është i papërgjegjshëm për faktin se nuk ka ofruar specifikimet teknike për multikultivator ashtu siç është kërkuar psh: eshtë kërkuar modeli GP6: 3C kurse OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar modelin D186F i njëjti OE nuk ka ofruar specifikim fare për fuqinë e multikultivatorit ku është kërkuar min 10HP gjithashtu nuk ka ofruar spec.teknik për shpejtuesin rrotulluese te multikultivatorit ku është kërkuar te jete 3600R/min po ashtu i njëjti OE nuk ka ofruar spec.teknik për shpenzimet e multikultivatorit ku është kërkuar max te jetë 4.51/H te gjitha këto specifikime dhe te tjera janë te cekura ne ankese dhe mos ti përsëriti edhe një here.

Se katalogu nuk është ofruar sipas kërkesës se Autoriteti Kontraktues e ka cekur edhe ekspertja shqyrtuese ne ekspertizën e saj. Gjithashtu ne jemi ofertuesit me çmim me te lire.

Gjate prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Fejza deklaroi: Tek pretendimi i parë lidhur me pretendimin e OE-së janë eliminuar pasi që janë rekomanduar për kontrate ju sqaroj se pas ankesës për ri shqyrtues që ka bërë OE Agri Bau kemi vërejtur se 2 referenca të OE ankues Rimida në atë rast kanë qenë të dyshimta sepse janë vulosur me vulën e OE Rimida kemi kërkuar sqarime shtese për këto 2 referenca janë sjellë tani me vule e cila është dashur të jete, kjo ka qenë e dyshimtë për ne për arsye se DJ PLUS është dashur ti lëshoj reference me vulën e vet ka bërë përmirësimin e saj dhe për ne është e dyshimtë edhe nëse e ka bërë datën e asaj kohe atëherë kemi kërkuar transaksione bankare që të bindemi për këto referenca dhe kontrata të bashkangjitura, nuk kanë qenë bindëse as transaksionet bankare sepse nuk janë përputhur të dhënat bankare me këto 2 referenca dhe fatura kanë pasur transaksione nga DJ PLUS por nuk janë përputhur me këto, ka pasur edhe disa referenca të tjera të listës që ka dorëzuar kanë qenë me OE privat persona fizik kemi kërkuar mirëpo është mbuluar me një fature, atëherë të gjitha këto nuk i kanë plotësuar minimumin e kërkuar të referencave në 3 vitet e fundit atëherë ne e kemi kthyer lenden në rivlerësim. Për shkak të këtyre të gjeturave OE RIMIDA është eliminuar dhe është shpallur OE AGRI BAU me çmim më të lartë dhe i përgjegjshëm.

Tek pretendimi i 2-të çështja e OE të rekomanduar për kontrata AGRI BAU nuk është e saktë se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka dorëzuar specifikimin teknik dhe OE i rekomanduar ka dorëzuar edhe deklaratën të nënshkruar dhe të vulosur ku zotohej gjegjësisht deklarohej me përmbushjen e specifikacionit teknik dhe merr zotimin se furnizimi do të kryhet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues. Pretendimet e OE ankues janë bazuar në specifikacioni nga Katalogu ku nuk janë të përshkruara në detaje deklarohet se ky specifikacion është me specifikime kryesore dhe thelbësore ndaj kjo nuk do të thotë se nuk përmbush apo nuk janë marrë parasysh në pjesën e paramasës dhe parallogarise por vlen të theksohet se as vet OE ankues në Katalogun që ka dorëzuar nuk i ka të dhënat në detaje, shihet i dorëzuar në oferte, ku të gjitha specifikimet teknike i ka edhe me të mangëta ku thuhet se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar multikultivator Modeli G6.3 kurse OE i rekomanduar ka ofruar D1.6F ju bëjë me dije se sipas LPP-së nuk lejohet të përcaktohet lloji apo tipi i prodhimit e nëse gjatë përpilimit aksidentalisht është paraqitur apo referuar ndonjë model apo llojit të caktuar atëherë mendojmë që kjo duhet të merret vetëm si referencë dhe në këtë rast mendojmë që duhet të lejohet lloji ekuivalent dhe nuk lejohet të kufizohet një lloj apo një model tjetër specifik. Thuhet se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga OE ankues multikultivator me fuqi 10 HP kurse OE i rekomanduar për kontrate nuk ka dhënë përshkrime teknike për këtë pikë as kjo nuk qëndron sepse kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë Motokultivator me fuqi 10 HP / min 6.3KW pra në specifikimet e dhënë 2 njësi matëse për fuqinë e multikultivatorit kurse OE i shpërblyer për kontrate ka të drejtë që ka ofruar njërin njësi matëse 6.3 KW gjegjësisht them se të

gjitha specifikacionet tjera ne katalog dhe paramasë janë te njëjta sipas kërkesës se Autoriteti Kontraktues dhe te 2 OE-te i kanë te ngjashëm.

Gjate prezantimit ne seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Fetoshi deklaroi: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te pranoj ankesën tone si te bazuar dhe te kthehet lënda ne rivlerësim.

Gjate prezantimit ne seancë përfaqësuesi i AK-së z. Fejza deklaroi: Kërkojmë te refuzohet ankesa e OE ankues dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se arsyeja e eliminimit të OE ankues ka qenë se i mungojnë referenca të mjaftueshme për tri vitet e fundit. Lidhur me këtë arsye të eliminimit, paneli shqyrtues me dt. 29.08.2019 gjatë mbajtjes së seancës dëgjimore ka kërkuar nga përfaqësuesi i OE ankues që brenda dy ditëve të sjell dëshmi transaksionet bankare në lidhje me dy kontratat e kontestuara e që janë të nënshkruara me kompaninë "DJ Plus Shpk", ndërsa OE ankues i ka ofruar dëshmi transaksione bankare ku vërehet që kanë qarkullim me kompaninë DJ Plus Shpk, mirëpo paneli shqyrtues konsideron, se nuk janë përputhur transaksionet me referencat si ne kohe dhe ne shumen e tyre.

Paneli shqyrtues vije ne përfundim se me te drejt AK e ka eliminuar operatorin ekonomik ankues Rimida pasi qe 2 referenca te OE ankues Rimida në atë rast nga ana e AK-së kanë qenë te dyshimta sepse janë vulosur me vulën e OE Rimida pastaj AK ka kërkuar sqarime shtese për këto 2 referenca janë sjellë tani me vule e cila është dashur te jete, kjo ka qenë e dyshimtë për AK për arsye se DJ PLUS është dashur ti lëshoj reference me vulën e vet, ka bërë përmirësimin e saj dhe për AK ka qene e dyshimtë edhe nëse e ka bërë datën e asaj kohe atëherë AK ka kërkuar transaksione bankare qe te bindet për këto referenca dhe kontrata të bashkangjitura, nuk kanë qenë bindëse as transaksionet bankare sepse nuk janë përputhur të dhënat bankare me këto 2 referenca dhe fatura, kanë pasur transaksione nga DJ PLUS dhe Rimida por nuk janë përputhur me këto dy referenca.

Autoriteti Kontraktues ne rastin konkret i ka shterur mundësitë e sqarimeve konform nenit 59 dhe 72 te LPP-së dhe ne rastin konkret OE i ankues sqarimet janë ne kundërshtim me nenin 72.3 te LPP-së ku thuhet se: *Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe*

mund të verifikohet në mënyrë objektive. Pra AK ne këtë rast nuk ka mundur ti verifikoj ne mënyrë objektive ekzistencën e dokumenteve –referencat te cilat i ka ofruar OE ankues, dhe AK me te drejte e ka eliminuar.

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontrate nuk i Plotëson specifikat e kërkuara nga Dosja e tenderit, paneli shqyrtues sqaron se te dy OE-te te paramasa dhe parallogaria e kanë përshkruar njëjtë specifikacionin teknik, ndërsa katalogët i kanë krijuar vet dhe i kanë shënuar specifikat e motokultivatoreve ku siç shihet asnjëri nuk i kanë te cekura te gjitha specifikat për motokultivatoret.

Me poshtë shihet katalogu për motokultivator i OE ankues dhe i OE te rekomanduar për kontrate:

Specifikat nga katalogu i OE ankues

Specifikat nga katalogu i OE te rekomanduar për kontrate

Kultivator BECKER
Fuqia: 10HP/7.35Kw
Motri: Diesel
Ndezja: Me suste
Volumi: Me kabin
mbuluse
Me bateri drita para
Lloje I motorit : KAMA
Doreze per : Stop
Emergjent
Numri I Rrotave: 400-8
Nje pale rrotafreza

TILLER ELECTRIC START

1. D186F diesel engine 6.3 kW(Rope and key Start)
KAMA LUXURY HANDLE WITH A TOOL BOX AND EMERGENT STOP
40 PIECES BLADES FOR CROSS KNIFE(2 SECTION)
BIG GEAR BOX
2 SHAFTS ON THE GEAR BOX
WITH THE ENGINE COVER AND 2 LED LAMPS
400-8 WHEEL

DIESEL POWER TILLER,
FUQIA: 6.3KW ,
KARBURANTI: DIESEL,
STARTI NDEZJA: DY OPSIONE ME NDEZJE ME SUSTA AUTOMATIKE (ROTOR DHE MBUSHESI I BATERIS) DHE MANUALE ME LITAR.
MADHESIA E RROTAVE: 400-8R ,
MOTORI: 3 SHPEJTESI (2 PARA DHE 1 MBRAPA).
FTOFJE ME AJER,
MBULESA ANSORE PER BROTA NGA METALI(KRILLA) .
NE PJESEN E SIPERME MOTORI DUHET TE JET I MBULAR KOMPLET ME KAPAK (HAUB) ADEKUATE, TE JET I PAISUR ME DRITA LED NE PJESEN E PERPARME.

Nëse hulumtojmë me shume ne web faqe ne linkun e me poshtëm :

<https://greenpower.en.made-in-china.com/product/vCDQOTSdGNkh/China-Green-Power-Diesel-Rotary-Cultivator-10HP-D186f-4-Stroke-Micro-Cultivator-Min-Tiller-with-Electric-Start.html>

do te gjejmë specifikat e modelit te motokultivatorit te OE te rekomanduar për kontrate, ku shihet qarte se pretendimet e ankuesit janë te pa bazuara pasi qe OE ankues pretendon se OE i rekomanduar ne vend qe ta ofroj modelin GP6.3C e ka ofruar modelin D186F, pra siç shihet ne web faqe këtu kemi te bëjmë me modelin e njëjtë, gjithashtu pretendimi se modeli i ofruar nga OE i rekomanduar për kontrate sipas ankuesit nuk e ka fuqinë min 10HP aty shihet qarte se e ka këtë fuqi gjithashtu edhe për numrin e rrotullimeve 3600R/min shihet qarte se modeli i OE te rekomanduar për kontrate e plotëson këtë kriter, pra motokultivatori i OE te rekomanduar për kontrate i plotëson specifikat, dhe këto pretendime janë te pa bazuara pasi qe secili lehtësisht mund ti vërtetoj me një hulumtim te thjesht ne internet.

Me poshtë e keni tabelën e modeleve te motokultivatoreve :

Model	GP4.2Q	GP5.4Q	GP8.2Q	GP3.8C	GP4.0C	GP6.3C	GP7.5C
Engine Name		Gasoline				Diesel	
Engine Model	170F (7HP)	177 (9HP)	188F (13HP)	D173F (5HP)	D178FA(E) (7HP)	D186FA(E) (10HP)	D188FA(E) (12HP)
Engine Type	1-cylinder, 4-stroke, air-cooled				1-cylinder, 4-stroke, air-cooled		
Power	4.2kw	5.4kw	8.2kw	3.8kw	4.0kw	6.3kw	7.5kw
Speed	3600r/min	3600r/min	3600r/min	3600r/min	3600r/min	3600r/min	3600r/min
Starting mode				Recoil Electric			
Fule volume	5.8L	5.6L	5.6L	2.5L	3.5L	5.5L	5.5L
Oil capacity	0.6L	0.8L	0.8L	0.75L	1.1L	1.6L	1.6L
Chursh style				Plate clutch			
Type of drive				Gear drive			
Gear shifting				2 0 1 R			
Cultivation width	60-110cm	70-110	70-110	60-110cm	70-110	70-110cm	70-110cm
Cultivation depth	10-25cm	10-25cm	10-25cm	10-25cm	10-25cm	10-25cm	10-25cm
Task speed	1-1.6km/h	1-1.6km/h	1-1.6km/h	1-1.6km/h	1-1.6km/h	1-1.6km/h	1-1.6km/h
Productivity	0.035-0.08hm ² /h	0.05-0.1hm ² /h	0.05-0.1hm ² /h	0.035-0.08hm ² /h	0.05-0.1hm ² /h	0.05-0.1hm ² /h	0.05-0.1hm ² /h
Oil consumption	12-15kg/hm ²	10-15kg/hm ²	10-15kg/hm ²	12-15kg/hm ²	10-15kg/hm ²	10-15kg/hm ²	10-15kg/hm ²
N.W.	80kg	105kg	115kg	80kg	115kg	125kg	125kg
G.W.	85kg	110kg	120kg	85kg	120kg	130kg	130kg
MEAS	84*51*63 cm	91*56*84 cm	91*56*84 cm	84*51*65 cm	91*56*84 cm	91*56*84 cm	91*56*84 cm

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna e Podujevës
- 1x1 OE- “ N.T Rimida ”- Graçanic,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.